



## **KËSHILLI BASHKIAK**

### **V E N D I M**

Nr. 38, datë 05.04.2017

#### **PËR**

#### **“ANËTARËSIMIN E BASHKISË SË TIRANËS NË SHOQATËN “BJCEM, BIENNALE DES JEUNES CREATEURS DE L’EUROPE ET DE LA MEDITERRANEE”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/ 1.1 shkronja “b”, pika 1/ 1.5, pika 1/ 1.6 dhe pika 2, nenit 25 pika 1, nenit 54 shkronja “d”, nenit 55 pikat 5 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, nenit 4 të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jofitimprurëse”, (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84, datë 29.12.2016 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”, (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

#### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë anëtarësimin e Bashkisë së Tiranës, si anëtare në shoqatën **“BJCEM, Biennale des Jeunes Createurs de l’Europe et de la Mediterranee”**.
2. Kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij, të përfaqësojnë Bashkinë e Tiranës në organet përfaqësuese të shoqatës, si dhe të kryejnë çdo veprim të nevojshëm që vjen si rrjedhojë e anëtarësimit në shoqatë.
3. Efektet financiare për pagesën e kuotës vjetore të anëtarësisë, do të përballohen nga buxheti i miratuar çdo vit për Bashkinë Tiranë dhe kryhet sipas parashikimeve të përcaktuara në statutin dhe aktet e shoqatës, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
4. Kuota e anëtarësisë për vitin 2017, në shumën prej 1.195 (njëmijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) euro, përballohet nga fondi i aparatit të Bashkisë në programin e Administratës Vendore për kuota anëtarësie.
5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**